25. Procedura e ankesës 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

-
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4)
1	Shërbime për mbrojtje nga sulmet kibernetike – <i>Komplet sipas Termave te References</i>	1		
	Çmimi total			_____
Çmimi Neto pa TVSH				
TVSH (%)				
Çmimi total me TVSH:				
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit				
Nënshkrimi				
Vula				
Datë _____				

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “Shërbime për mbrojtje nga sulmet kibernetike”

Afatet e ekzekutimit: 1 (nje) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Shërbime për mbrojtje nga sulmet kibernetike		OST sh.a.	1 (nje) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

Historiku

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a është një shoqëri aksionare shtetërore, e krijuar me datë 14/07/2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare në tre shoqëri të veçanta. OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

1. Furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
2. Transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
3. Tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit;

Hyrje

Sistemi i Monitorimit dhe Inteligjencës ndaj Sulmeve Kibernetike është një mekanizëm i avancuar që synon të parandalojë, zbulojë dhe përgjigjet në kohë reale ndaj kërcënimeve kibernetike. Ky sistem përfshin përdorimin e teknologjive të monitorimit të rrjetit, analizës së të dhënave dhe algoritmave inteligjentë që ndihmojnë në identifikimin e aktiviteteve të dyshimta ose anormale brenda infrastrukturës IT.

Qëllimi kryesor është të sigurojë mbrojtje proaktive duke analizuar sjelljet në rrjet, trafikun, log-et dhe burime të tjera për të zbuluar shenjat e hershme të një sulmi potencial. Përveç kësaj, sistemi ndërvepron me databaza globale të kërcënimeve (threat intelligence) për të përditësuar njohuritë mbi taktikat dhe mjetet që përdorin sulmuesit.

Zbatimi i një sistemi të tillë është kritik për OST sh.a që menaxhon të dhëna të ndjeshme dhe infrastrukturë kritike, pasi ndihmon në minimizimin e dëmeve, përmirësimin e reagimit ndaj incidenteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike.

KËRKESA FUNSKIONALE MINIMALE

- Numri i aseteve që do të monitorohen duhet të jetë minimalisht 35.
- Nuk duhet të ketë limit në numrin e përdoruesve.
- Sistemi duhet të jetë i vlefshëm për 1 vit.
- Sistemi mund të ofrohet si platformë e instaluar “on-site” ose si platformë “on cloud”. Në rastin e instaluar “on-site” ofertuesi duhet të përfshijë të gjitha pajisjet teknologjike për të mundësuar operimin e sistemit në kushte optimale përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Menaxhimi i Përdoruesve

- Sistemi duhet minimalisht të mbështesë funksionalitetin e rivendosjes së fjalëkalimit nga vetë përdoruesi.
- Duhet të ofrojë funksionalitetin “Harrova fjalëkalimin”.
- Duhet të detyrojë përdoruesin të ndryshojë fjalëkalimin në hyrjen e parë.
- Duhet të integrohet me SMTP për të njoftuar përdoruesin për çdo ndryshim në llogarinë e tij.

-
- Sistemi duhet të zbatojë verifikime strikte të politikës së fjalëkalimeve.

Autentikimi

- Sistemi duhet të ketë të integruar plotësisht një platformë menaxhimi identitetesh, duke lejuar:
 - Autentikim me 2 faktorë (2FA),
 - Mbrojtje ndaj sulmeve brute-force,
 - Menaxhim i roleve dhe lejeve të përdoruesve përmes një sistemi të centralizuar.
- Sistemi duhet minimalisht të bllokojë automatikisht përdoruesit pas disa përpjekjesh të dështuara për hyrje.
- Në rast të ndryshimeve në lejet e përdoruesit, sistemi duhet të kryejë daljen automatike (logout) të tij.

Auditim

- Sistemi duhet të përfshijë një mekanizëm auditimi për të regjistruar aktivitetin e përdoruesve.
- Log-ët duhet të ruhen në një vend të centralizuar dhe nuk duhet të ketë kufizime për sasinë e log-eve për përdorues.

Backup

- Duhet të kryhet backup ditor për të gjitha bazat e të dhënave, me mundësi rikthimi (restore) deri një ditë mbrapa.

Qeverisja e të Dhënave (Data Governance)

- Sistemi duhet të zbatojë kontroll të qasjes së përdoruesve në nivel aplikacioni, bazuar në kufizimet e secilit.

Logim dhe Monitorim Qendror

- Duhet të mbështetet mbledhja dhe ruajtja qendrore e log-eve nga të gjithë komponentët e sistemit.
- Duhet të ofrojë mundësi të avancuar për kërkime dhe pamje statistikore të log-eve.

Siguria

- Infrastruktura duhet të kalojë skanime të vazhdueshme të dobësive në burimet cloud dhe endpoint-et përmes mjeteve standarde dhe personelit SOC.
- Qasja në sistem duhet të kalojë përmes një Web Application Firewall (WAF).
- Qasja duhet të jetë e lejuar vetëm nga IP të lejuara (IP whitelisting).
- Të gjitha të dhënat duhet të jenë të kriptuara në nivel disku me algoritmin AES-256, si dhe komunikimi të jetë TLS i sigurt.

Infrastruktura

- Sistemi duhet të jetë i ndërtuar mbi arkitekturë moderne (si psh duke përdorur Kubernetes dhe micro services).

KERKESA FUNKSIONALE

1. Plane Monitorimi të Personalizuara - Sistemi duhet minimalisht të mbështesë krijimin e planeve të personalizuara të monitorimit, të menaxhuara nga vetë për analizë inteligjence dhe personel sigurie.

- Monitorim bazuar në kategori tematike.
- Monitorim i vazhdueshëm i automatizuar përmes konfigurimit fillestar.
- Përmban template të gatshme për grupe të ndryshme përdoruesish.

2. Modifikim i panelit qendror (Central Dashboard) - Sistemi duhet të ofrojë dashboard të personalizueshëm për të gjithë përdoresit:

- Widget statistikore të bazuara në mbledhjen aktuale të të dhënave.
- Widget me burime të inteligjencës kibernetike në kohë reale.
- Widget të personalizuar nga përdoresi mbi pyetje dhe filtra specifike.

3. Panel Qëndror i Integruar me të dhëna nga GenAI (Generative Artificial Intelligence) - Sistemi duhet të mbështesë panel (*dashboard*) të bazuar në GenAI që jep ndarje pamjesh mbi rreziqet sipas sektorit apo rajonit:

4. Kategorizimi i rrezikut bazuar në GenAI (GenAI Threat Scoring) - Sistemi duhet të ofrojë vlerësim të automatizuar të kërcënimeve:

- Algoritme scoring të bazuara në sjelljen e analistëve.
- Prioritizim dhe klasifikim fleksibël sipas STIX dhe nevojave të përdoresit.

5. Qëndër për alarmet - Sistemi duhet të lejojë krijimin e alarmeve të personalizuar:

- Njoftime të bazuara në parametra si aktorë, domen, burim etj.
- Alarmet e parakonfiguruar sipas skenarëve si Ransomware, Leaked Records, etj.

6. Menaxhimi e ceshtjeve/rasteve - Sistemi duhet të mbështesë menaxhimin e rasteve dhe incidenteve:

- Përmban mjete intuitive për të lidhur rezultate me raste hetimi.
- Pa kufizime në numrin e rasteve dhe rezultateve për rast.

7. Filtra mbi të dhënat e Inteligjences - Sistemi duhet të mbështesë filtra dhe pamje statistikore:

- Të dhënat filtrohen pa kufizim, me pamje intuitive dhe "*slice & dice*"

8. Zgjidhje/kategorizime të paracaktuara (Predefined Mitigations) - Sistemi duhet të ofrojë rekomandime të gatshme për kategorizim të rasteve të zbuluara:

- Rekomandime të paracaktuara për skenarë të ndryshëm si malware, rrjedhje të dhënash
- Menaxhim i zbatimit të rekomandimeve me date dhe gjurmim statusi.

9. Portal Investigimi - Sistemi duhet të lejojë pyetje ad-hoc të pakufizuara:

- Mbështet burime të shumta si Deep/Dark Web, forume, IM, etj.

10. Mjete për raportime - Sistemi duhet të lejojë krijimin e raporteve PDF të personalizuar:

- Eksportim pa kufizim nga dashboard drejtues

11. Kërkese për Inteligjencë (Request for Intelligence (RFI)) - Sistemi duhet të ofrojë funksionalitet RFI për bashkëpunim me analistët:

- Mbështetje në hetime ad-hoc dhe analiza nga ekspertë të fushave të ndryshme

12. Export - Sistemi duhet të mbështesë eksportimin e të dhënave:

- PDF, CSV dhe JSON

13. Integritet - Sistemi duhet të ofrojë RESTful API sipas STIX dhe integrim me SIEM, SOAR, TIP etj.

14. GenAI Cyber Feeds - Sistemi duhet të ketë feeds të pasura nga GenAI me kontekst dhe histori të thellë:

- Aktorë, TTP, CVE, industri të synuara dhe mbi 10 vite histori

Sistemi i Inteligjencës së Kërcënimeve Kibernetike (CTI)

(a) **1. Raporte dhe Alarme Inteligjence (Proprietary Threat Intelligence Reports and Alerts)**

- Platforma CTI duhet të ofrojë qasje në:
 - Rrjedhë të vazhdueshme të output-eve të inteligjencës së kërcënimeve.
 - Arkiv historik të raporteve dhe alarmeve të inteligjencës.
- Përmbajtja duhet të përfshijë:
 - Raporte të synuara për organizatën.
 - Inteligjencë sektoriale dhe ndërsektoriale.
 - Raporte rajonale dhe globale.

(a) **2. Rrjedha Ditore e Inteligjencës (Daily Intelligence Feeds)**

- CTI duhet të përmbajë:
 - Rrjedhë ditore inteligjence të gjeneruar nga AI dhe analistë të sigurisë.
 - Qasje në mbi 10,000 artikuj inteligjence të analizuar historikisht.
 - Përmbledhje dhe analizë të incidenteve globale të sigurisë kibernetike.

(a) **3. Rekorde të Rrjedhura (Leaked Records Monitoring)**

- Sistemi duhet të sigurojë paralajmërime të hershme për rekorde të rrjedhura në *Deep & Dark Web*.
- Të përmbajë motor të të dhënave me mbi 20 miliardë kredenciale të rrjedhura dhe të verifikuara.

(a) **4. Tregues të Komprometimit të Bazuar në Inteligjencë (Intelligence-based IOCs)**

- Të ofrojë qasje në IOCs të verifikuara nga njerëzit.
- Çdo IOC të ketë kontekst (aktor kërcënues, malware, fushatë sulmi, etj.).
- Të përfshijë dhjetëra mijëra tregues dhe përditësime javore.

(a) **5. Të Dhëna për Aktorët Kërcënues (Threat Actor Intelligence)**

- Mbledhje e të dhënave për katër kategori aktorësh:
 - Shtete kombëtare, kriminelë kibernetikë, haktivistë, dhe terroristë kibernetikë.
- Informacioni të jetë në formën e IOCs, TTPs (në përputhje me MITRE ATT&CK), dhe raporte të përfunduara.

(a) **6. Mbulim në Shumë Gjuhë (Multi-language Support)**

- CTI duhet të mbështesë grumbullim të automatizuar të të dhënave në dhjetëra gjuhë.
- Fokusimi duhet të jetë në industrinë e organizatës dhe kërkesat për gjueti kërcënimesh.

(a) **7. Forume të Mbyllura në Deep & Dark Web**

- Platforma duhet të monitorojë forume të mbyllura ku ndodhin shkëmbime të mjeteve të sulmit, malware, etj.
- Të ketë akses në qindra milionë të dhëna.

(a) **8. Tregje të Zeza (Black Marketplaces)**

- Monitorim i vazhdueshëm i tregjeve të zeza ku shkëmbehen të dhëna të vjedhura dhe eksplot-e.
- Akses në qindra milionë të dhëna.

(a) **9. Dyqane për kartat (Carding Stores)**

-
- Vëzhgim i dyqaneve të carding ku tregtohen të dhëna të kartave të kreditit të bankave.
 - Të përmbajë qindra milionë të dhëna.
 - (a) **10. Aplikacione me mesazhe te drejtperdrejta (Instant Messaging)**
 - Mbledhje nga aplikacione si Telegram, Discord, ICQ, Jabber, IRC.
 - Akses në miliarda postime të lidhura me kërcënime kibernetike.
 - (a) **11. Platforma për Shkëmbim Tekstesh (Paste Sites)**
 - Akses në platforma ku publikohen të dhëna të rrjedhura, lista objektivash, dhe kod malware.
 - (a) **12. Depo online me Kode (Code Repositories)**
 - Monitorim i platformave si GitHub për zbulimin e POC-ve, exploit-eve dhe mostrave malware.
 - (a) **13. Rrjete Anonime (Anonymous Networks)**
 - Akses në rrjete të tilla si Darknet dhe ZeroNet.
 - (a) **14. Monitorim Domain-esh (Domain Monitoring)**
 - Detektim i emrave të domain-eve të sapo regjistruar që mund të përdoren për mashtrime.
 - Përditësim ditor i të dhënave.
 - (a) **15. Database të Dobësive (Vulnerability Databases)**
 - Grumbullim i informacionit nga DB të dobësive që përditësohen rregullisht.
 - (a) **16. Feeds dhe Buletine të Sigurisë (Security Bulletins & RSS)**
 - Mbështetje për grumbullim të të dhënave nga burime RSS të CERT-eve dhe burimeve të tjera zyrtare të sigurisë.
 - (a) **17. MOnitorim te Sipërfaqes se Sulmit të Jashtëm (External Attack Surface Monitoring)**
 - Integrim me feed-e EASM për monitorim të aseteve dixhitale të ekspozuara.
 - Përfshin prioritizim dhe korelacion të automatizuar të kërcënimeve.
 - (a) **18. Feed Komerciale AGTI (Adversary-Generated Threat Intelligence)**
 - Inxhinierim i të dhënave të gjeneruara nga kundërshtarët për përmirësim të detektimit.
 - Feed-et përmbajnë IOC cilësor të gjeneruar përmes teknologjive të mashtrimit (*deception*)

Modulet Shtesë të CTI

1. Moduli për Parandalimin e Mashtrimeve me Kartela Krediti (*Credit Card Fraud Mitigation Module*)

- Sistemi CTI duhet të përfshijë një modul të dedikuar për zbulimin dhe parandalimin e tregtimit ilegal të të dhënave të kartelave bankare në *Dark Web*.
- Ky modul duhet të përdorë:
 - Mbulesën e burimeve të sistemit (source coverage).
 - Planin e Monitorimit të personalizuar të organizatës.
- Duhet të ofrojë zbulim, analizë dhe ndërhyrje automatike ndaj aktiviteteve të paligjshme të tregut të zezë që përfshijnë të dhëna të kartelave.

2. Moduli i Profilizimit të Aktorit të Kërcënimeve (*Threat Actor Profiling Module*)

-
- Sistemi duhet të ofrojë një modul të automatizuar për analizën dhe profilizimin e aktorëve kërcënues.
 - Kërkesat minimale funksionale:
 - Gjenerimi i menjëhershëm i kartelave të inteligjencës për aktorët kërcënues në Deep/Dark Web dhe aplikacione IM.
 - Teknologji e bazuar në AI për analizimin e temave të interesit, besueshmërisë, historikut të aktivitetit dhe treguesve të lidhur (IOCs).
 - Duhet të mundësojë krijimin e profileve në kohë reale për përdorim të brendshëm nga ekipet e sigurisë.
-

3. Moduli për Menaxhimin e Sipërfaqes së Sulmit të Jashtëm (*Attack Surface Management Module – EASM*)

- Sistemi CTI duhet të përmbajë një modul të EASM të integruar dhe të personalizuar sipas aseteve të organizatës.
 - Karakteristika të kërkuara:
 - Prezantim i aseteve të ekspozuara, të cenueshme ose të komprometuara.
 - Atribuim i pikëzimit të rrezikut për çdo aset.
 - Mbështetje për grumbullim të të dhënave nga feed-e komerciale, *Deep/Dark Web* dhe inteligjenca proprietare.
 - Korelim dhe pasurim i të dhënave për përmirësim të vendimmarrjes.
-

4. Moduli i Inteligjencës për Dobësitë (*Vulnerability Intelligence Module*)

- Sistemi duhet të ofrojë një modul të inteligjencës për dobësitë që ndihmon në prioritarizimin e përditësimeve të sigurisë.
 - Kërkesat funksionale përfshijnë:
 - Informacion të kontekstualizuar rreth dobësive në sistemet dhe teknologjitë e përdorura nga organizata.
 - Qëllimi i modulit duhet të jetë: forcimi i qëndrueshmërisë kibernetike dhe optimizimi i ciklit të patching.
-

5. Moduli për Kredenciale të Komprometuara (*Compromised Credentials Module*)

- Moduli duhet të ofrojë inteligjencë në kohë reale për të dhënat e rrjedhura që prekin organizatën.
 - Të përfshijë detektim të:
 - Kredencialeve të infostealer-ëve (vjedhje nga përdorues të infektuar).
 - Llogarive email të stafit të rrjedhura përmes kompromentimeve të palëve të treta.
 - Kredencialeve të zyrtarëve të lartë/VIP të publikuara në platforma kërcënuese.
-

6. Moduli i Inteligjencës për Phishing (*Phishing Intelligence Module*)

- Sistemi duhet të përfshijë një modul të avancuar për detektim dhe analizë të fushatave phishing.
- Karakteristika të kërkuara:

-
- Detektim Proaktiv i Automatizuar: Zbulim i tentativave të phishing përpara se të shndërrohen në kërcënim aktiv.
 - Monitorim i Vazhdueshëm: Përfshirje e miliona domain-eve, subdomain-eve dhe certifikatave SSL.
 - Inteligjencë e Thelluar për Domain-et: Analizë teknike automatike për hetim të avancuar.
 - Vlerësim i Rrezikut dhe Prioritarizim: Vlerësim i kërcënimeve me pikëzim të qartë për menaxhimin efikas të incidenteve.

Raportim, Alarme dhe Shërbime Mbështetëse të CTI

1. Raporte Periodike të Personalizuara (*Periodical Targeted Reports*)

- CTI duhet të ofrojë raporte të inteligjencës së kërcënimeve të personalizuara, që përfshijnë:
 - Sulme kibernetike të fundit dhe në zhvillim.
 - Tendenca të kërcënimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në organizatë.
 - Kërcënime që lidhen me industrinë përkatëse dhe rajonet gjeografike të interesit.
 - Fushat e interesit dhe prioritetet përcaktohen përmes një Pyetësoi Kibernetik të plotësuar nga klienti.
-

2. Raporte Premium Strategjike (*Premium Intelligence Reports*)

- Përveç raporteve periodike, CTI duhet të ofrojë:
 - Raporte inteligjence strategjike me kërkesë, të përcaktuara bashkërisht me klientin.
 - Tematika mund të përfshijë:
 - Analiza të grupeve sulmuese.
 - Hulumtime të thelluara të tendencave në Deep/Dark Web.
 - Hetime mbi kapacitetet ofensive kibernetike të një shteti.
 - Përkufizimi dhe dorëzimi i raporteve premium bëhet sipas marrëveshjes komerciale dhe nevojave të sigurisë së klientit.
-

3. Alarme të Kërcënimeve në Kohë Reale (*Threat Alerts*)

- CTI duhet të dërgojë alarme urgjente kur identifikohen kërcënime të menjëhershme, të lidhura me:
 - Infrastrukturën kritike të organizatës.
 - Industrinë përkatëse.
 - Fusha të veçanta operimi.
 - Alarmerimi duhet të prodhohet nga ekspertë të sigurisë dhe inteligjencës, bazuar në analiza aktuale dhe kontekstuale të kërcënimeve.
-

4. Tregues të Komprometimit të Bazuar në te dhenat nga Inteligjenca (*IOC Data*)

- Sistemi duhet të sigurojë:
 - IOC të validuara, të përditësuara në baza javore.

-
- Treguesit të jenë të lehtë për implementim në sistemet e organizatës.
 - Vëllimi të jetë nga disa dhjetëra deri në disa qindra tregues në javë.
 - Të përfshijnë informacione mbi malware, domenë, IP, URL, hashe, etj.
-

5. Rrjedhe informacionesh Ditore Inteligjence – GenAI CTI Feeds (*Daily Intelligence Feeds*)

- Rrjedha ditore të prodhuara nga teknologji GenAI, që përfshijnë:
 - Analizë të vazhdueshme të incidenteve, dobësive të reja, fushatave malware dhe aktorëve të kërcënimeve.
 - Shpërndarje nga e Diela deri të Enjten.
 - Rreth 150 artikuj në muaj me përmbledhje dhe analiza të thella.
-

6. Shërbime për Mbylljen e Shërbimit Malicioz (*Take-Down Services*)

- CTI duhet të ofrojë shërbime për heqjen e aseteve të rrezikshme ose mashtruese, përfshirë:
 - Domain-e të dyshimta që imitojnë organizatën.
 - Llogari mashtruese në rrjete sociale.
 - Aplikacione mobile të rreme që keqpërdorin identitetin e organizatës.
- Shërbimi të ofrohet përmes ekipeve të specializuara të analistëve, me mbështetje të dokumentuar për ndërmarrjen e veprimeve ligjore ose teknike.

Shërbime mbi Menaxhimin

1. Mbështetje për Multi-Tenancy / MSSP (*Multi-Tenancy for Managed Security Service Providers*)

- Sistemi CTI duhet të mbështesë menaxhimin e shumë klientëve nga një Ofrues i Shërbimeve të Sigurisë së Menaxhuar (MSSP).
 - Funksionalitetet minimale që duhet të ofrohen:
 - Krijimi dhe menaxhimi i llogarive të veçanta për klientët.
 - Krijimi i përdoruesve dhe caktimi i kuotave për secilin klient.
 - Përcaktimi i Planit të Monitorimit për secilën llogari.
 - Analizimi i të dhënave të mbledhura dhe krijimi i rasteve (Cases).
 - Gjenerimi i alarmeve (Alerts) bazuar në analiza.
 - Sistemi duhet të mbështesë shkallëzim horizontal, me kapacitet për të menaxhuar dhjetëra deri në qindra llogari.
-

2. Pamje e Përmbledhur e Aktivitetit

- CTI duhet të ofrojë një ekran përmbledhës në panelin administrativ që përfshin:
 - Statistika sipas industrisë së klientëve, të dhëna të mbledhura, numër përdoruesish për secilin klient.
 - Përmbledhje të aktivitetit në nivel platforme në formë grafike përmes widget-ëve interaktivë.
 - Aftësi për filtrim të të dhënave sipas kriterëve të parapërcaktuara.
-

3. Menaxhimi i Llogarive

- Paneli administrativ duhet të lejojë:
 - Menaxhimin e cilësimeve të secilës llogari.
 - Konfigurimin e Planit të Monitorimit në mënyrë të personalizuar për secilin klient.
 - Aktivizimin e funksioneve të veçanta për çdo llogari në mënyrë të pavarur.
-

4. Personalizimi i Pamjes së Panelit

- CTI duhet të ofrojë një panel për konfigurimin vizual të ndërfaqes për çdo llogari, që përfshin:
 - Vendosjen e emrit dhe logos së personalizuar për secilin klient.
 - Përcaktimin e layout-it të widget-ëve në dashboard.
 - Caktimin e pamjes dhe ndarjeve në mënyrë të përshtatur për secilën llogari.
-

5. Menaxhimi i Përdoruesve

- Sistemi duhet të ofrojë menaxhim të plotë të përdoruesve për secilën llogari përmes panelit administrativ:
 - Krijimi, aktivizimi/deaktivizimi dhe fshirja e përdoruesve.
 - Caktimi i roleve të veçanta: Administrator, Analist, dhe Vëzhgues (Observer – vetëm shikim).
 - Rivendosje e fjalëkalimeve dhe menaxhim i aksesit sipas roleve.

Shënime:

- Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- Kudo ne Specifikiet Teknike ku është cituar standard ndërkombëtar, do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshiruar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**
- b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 1,600,000 (nje milion e gjashteqind mijë) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 800,000 (teteqind mijë) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2. *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve (te përkthyer dhe te noterizuara), te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- *ISO 9001: në fushën e menaxhimit te cilësisë, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.*
- *ISO 27001: Per menaxhimin e sigurise se informacionit, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.*
- *ISO 20000-1: Per sistemin e menaxhimit te shërbimit, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.*

2.3.3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizimin e prodhuesit/distributorit te autorizuar per objektin e prokurimit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

2.3.4. *Operatori ekonomik duhet te disponoje stafin teknik si vijon:*

- ✓ *Te pakten 1 punonjes te certifikuar per menaxhimin e sigurise se informacionit ndaj sulmeve kibernetike.*
- ✓ *Te pakten 1 punonjes per menaxhimin e shërbimeve IT ne nivel ITL.*

Shënim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikate.

Operatori Ekonomik ofertues mund te disponoje punonjesit e mesiperm ne dy menyra:

- i. *Ne stafin e tij dhe per kete duhet te kete listepagesen e fundit e-sig, kontratat e punes dhe certifikimet perkatese.*
- ii. *Me ane te kontraktimit dhe per kete duhet te kete kontraten noteriale dhe certifikimet paktese.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin si prove paraprake formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.5. *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 10 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Shtojca 10.**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

